

## **Lulzim BASHA**



**Datëlindja:** 12.06.1974

**Vendlindja:** Tiranë

**Email:** Lulzim.Basha@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Në vitin 1993, Basha nisi studimet në Universitetin e Utrechtit në Holandë, ku mori titullin Jurist (Meester in de Rechten ekuivalenti i LLM) i specializuar në të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare publike.

Gjatë periudhës korrik 2000 – tetor 2001 ai ushtroi detyrën Këshilltar Ligjor në Departamentin e Drejtësisë së Administratës së Kombeve të Bashkuara UMNİK në Kosovë. Nga tetori i vitit 2001 deri në nëntor 2002 punoi si Zëvendëseshëf i Kabinetit të Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut. Nga nëntori i vitit 2002 deri në janar 2005 punoi si Këshilltar Special për Tranzicionin në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, Prishtinë, Kosovë.

Basha iu bashkua Partisë Demokratike të Shqipërisë në janar të vitit 2004 si Koordinator i Komitetit të Orientimit të Politikave (KOP) në Partinë Demokratike.

Ai u bë anëtar i kryesisë së partisë në maj të atij viti dhe shërbeu si zëdhënës i partisë gjatë zgjedhjeve parlamentare vitit 2005 në të cilat ai u zgjodh në Kuvendin e Shqipërisë si deputet.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, Lulzim Basha u bë Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ku ai shërbeu për një periudhë prej dy vjetësh, derisa ai u emërua Ministër i Punëve të Jashtme në vitin 2007 dhe shërbeu si Ministër i Punëve të Jashtme në perjudhën (2007-2009).

Pas zgjedhjeve të vitit 2009 në të cilat Lulzim Basha u zgjodh deputet i Elbasanit, ai u emërua si Ministër i Brendshëm.

Në vitin 2011, Basha u zgjodh në postin e kryetarit të Bashkisë së Tiranës (2011-2015).

Nga viti 2005 dhe në vazhdim është anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe anëtarë i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Që nga viti 2013 dhe në vazhdim ka ushtruar postin e Kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë.